

Subjunctive: Its Distribution in Complex Sentences in Albanian

Abstract: *The purpose of this paper is to describe and analyse the subjunctive mood in Albanian as well as its distribution in complex sentences. It is a theoretical-analytical examination of the subjunctive, namely, of the distribution of the subjunctive in sentences with adjunct, complement and relative clauses. In sentences with adjunct clauses there are various factors influencing the selection of the subjunctive. In some cases, the semantic properties of the conjunction require the subjunctive, or the correlation created by the conjunction with certain tense and mood verb forms. On the other hand, in complement clauses the subjunctive is usually selected by the semantic and syntactic properties of the matrix verb. In Albanian, the subjunctive is consistently required by certain verbs, e.g. nis 'start', filloj 'begin', vazhdoj 'continue', whose semantics differ from the concept of the subjunctive. In relative clauses, the selection of the subjunctive is determined by non-referential use of the noun in the matrix clause, being connected to its indefinite form.*

Keywords: *subjunctive, distribution, selection, main verb, conjunction.*

1. Hyrje

Lidhorja është njëra nga pesë mënyrat e foljes në gjuhën shqipe, krahas mënyrave të tjera, që janë dëftorja, habitorja, dëshirorja e urdhërorja¹. Formalisht lidhorja dallon nga dëftorja (*punoj*) nëpërmjet pjesëzës të: *të punoj*, dhe zgjedhohet në kategorinë e vetës e të numrit:

m. dëftore

punoj *punojmë*
punon *punoni*
punon *punojnë*

m. lidhore

të punoj *të punojmë*
të punosh *të punoni*
të punojë *të punojnë*

1 SH. DEMIRAJ, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1988, 925; K. TOPALLI, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2012, 867-870; B. ISMAJLI, *Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja*. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë 2012, 473-481.

Krahas kohës së tashme, lidhorja në shqipen ka edhe tri dallime të tjera kohore: të pakryerën të *punoja*, të kryerën të *kem punuar* dhe më se të kryerën të *kisha punuar*².

Zakonisht në trajtimet teorike për mënyrat e foljes dhe për modalitetin³ lidhorja⁴ është përkufizuar duke u vënë në kundërvënie me dëftoren. Në aspektin konceptual, dëftorja është mënyra e foljes e cila përdoret për të paraqitur një pohim apo për të paraqitur një situatë⁵ faktuale⁶, reale, të sigurt (1a), ndërsa lidhorja është mënyrë e foljes e cila nuk përdoret për të paraqitur një pohim. Ajo përdoret për të paraqitur një situatë jofaktuale, joreale, të pasigurt (2a dhe b). Për këtë kundërvënie brenda kategorisë së mënyrës, Palmeri⁷ propozon dallimin terminologjik *realis* - *irrealis*, duke u mbështetur në natyrën teknike të këtyre termave.⁸ Kështu, dëftorja është mënyrë e foljes *realis*, ndërsa lidhorja bën pjesë në kategorinë e mënyrave *irrealis*:

1. Ajo **punon** këtu.

2. a) **Të punojmë** bashkë.

b) Ajo dëshiron **të punojë** këtu.

Gjersa përdorimi i dëftores 1) paraqet një pohim të folësit, që është në përputhje me realitetin, një situatë faktuale apo situatë e cila ka ndodhur,

2 SH. DEMIRAJ (ed.), *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2002, 293.

3 Shih: F. R. PALMER, *Mood and Modality*, Cambridge Textbooks in Linguistics, Cambridge 2001; T. GIVON, *Syntax* (Vol. I), John Benjamins Publishing Company, Amsterdam – Philadelphia 2001.

4 Të kemi parasysh se këtu termi *lidhore*, për të ilustruar dallimin dëftore-lidhore, nënkupton jo vetëm lidhoren si një mënyrë e foljes, por krahas saj, edhe mënyrat e tjera, si urdhëroren, dëshiroren, kushtoren. Ndërsa, në këtë punim, lidhorja trajtohet në kuptimin e ngushtë të fjalës, si një mënyrë e gramatikalizuar brenda sistemit foljor të shqipes.

5 Termi *situatë* nënkupton ngjarjen, gjendjen a veprimin e shprehur nga folja në fjali.

6 Përkon me realitetin objektiv.

7 PALMER, *Mood and Modality*, 2001, 1.

8 Palmeri phon se termat e tillë si mënyrë *reale/joreale* apo *faktuale/jofaktuale* nuk janë të përshtatshëm për shkak të konotacionit të tyre logjik, dhe po ashtu nuk janë të përshtatshëm për të shpjeguar plotësisht dallimin ndërmjet kategorive *realis* dhe *irrealis*. Më tutje, ai argumenton se kategoria *irrealis* në gjuhë të ndryshme mund të realizohet me mjete të ndryshme gramatikore, madje në gjuhë të caktuara ndodh që ajo që konsiderohet *irrealis*, mund të shprehë diçka që është reale, rrjedhimisht edhe faktuale, por që nuk është informacion i pohuar. Prandaj, nuk është faktualiteti apo realiteti gjithnjë vetia kryesore që karakterizon mënyrën *irrealis*, por është mungesa e shprehjes së një pohimi. Në këtë punim, në përpjekje për të ruajtur saktësinë e tij, termi *irrealis* është përdorur ashtu siç përdoret në literaturën mbi të cilën mbështetet punimi. Në gjuhësinë shqiptare, në këtë mënyrë, termi *irrealis* është përdorur nga Rugova, shih: B. RUGOVA, *E ardhmja në bast – Futuri i shqipes*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (38), Prishtinë, 2019, 9-42.

përdorimi i lidhore nuk paraqet një pohim të tillë. Lidhorja paraqet një situatë që ende nuk ka ndodhur, nuk është faktuale, por është e pritshme, e mundshme, e pasigurt, e dëshirueshme, ashtu siç është paraqitur në ilustrimet në (2a) dhe (2b).

Ky shpjegim për lidhoren duke e krahasuar me dëftoren duket mjaft i qartë, por gjithsesi mjaft i përgjithshëm nëse e krahasojmë me mënyrat e tjera irrealis në gjuhën shqipe, me urdhëroren e dëshiroren, që në shqipen janë mënyra të tjera të gramatikalizuara. Kur e krahasojmë trajtën e lidhore të *shkoj*, me trajtat e mënyrave të tjera, p.sh. të urdhërores *shko* e të dëshirores *shkofsh*, do të shohim se jashtë një konteksti të caktuar, përmbajtja e lidhore është vështirë të interpretohet: vetë trajtat *shko*, *shkofsh*, shërbejnë për të shprehur urdhër, përkatësisht dëshirë, gjersa trajta e lidhore të *shkoj*, përtej faktit që shpreh një situatë të paaktualizuar, jofaktike, është vështirë t'i përcaktohet një përmbajtje specifike modale. Që të tria kanë të përbashkët tiparin e të shprehurit të jofaktualitetit, të një situatë të paaktualizuar, të pritshme, prandaj që të tria hynë në kategorinë e irrealisit, por që lidhore i mungon një përmbajtje specifike modale si në rastin e dy mënyrave të tjera. Bybee et al⁹. pohon se analizat për lidhoren shpesh kanë qenë të diskutueshme sepse nuk është e qartë nëse format e saj kanë një përmbajtje semantike të caktuar apo janë elemente semantike boshe që shfaqen në bazë të kërkesave sintaksore.

Në gjuhën shqipe lidhorja përdoret në disa tipa të klauzave¹⁰ të varura (ndonëse ajo përdoret edhe në fjali të thjeshta, por këtu nuk do të ndalemi në këtë çështje). Ky fakt theksohet në Gramatikën e Akademisë¹¹, por në këtë gramatikë, në vend të termit klauza përdoret termi fjali të nënrenditura.

Përdorimi i lidhore në klauzat e këtyre fjalive përcaktohet nga disa

9 J. BYBEE, R. PERKINS, W. PAGLIUCA, *The Evolution of Grammar: Tense, Aspect and Modality in the Languages of the world*, The University of Chicago Press - Chicago and London 1994, 213.

10 Në traditën sintaksore të shqipes, njësia kumtuese që ka dy e më shumë njësi kallëzuesore e që karakterizohet nga një intonacion i mbarimit, është quajtur *fjali e përbërë*, ndërsa njësitë kallëzuesore përbërëse të saj janë quajtur *fjali të nënrenditura* a *të bashkërenditura*, ose edhe *pjesë të fjalisë*. Në këtë punim, termi *klauzë* është përdorur për t'iu referuar pjesëve të fjalisë së përbërë: *klauzë drejtuese* dhe *klauzë e varur a nënrenditur*, në vend të termit të gramatikës tradicionale *fjali drejtuese*, përkatësisht *fjali e varur a nënrenditur*. Termi *klauzë* është përdorur në këtë mënyrë, me qëllim që të shmanget dykuptimësia e termit *fjali*: edhe për t'iu referuar tërësisë, edhe pjesës së saj. Në gjuhësinë shqiptare ky term ka hyrë nën ndikimin e traditës sintaksore të gjuhës angleze, shih p.sh. R. HUDDLESTONE, G.K. PULLUM, *The Cambridge Grammar of the English Language*, CUP, Cambridge, 2002; Së pari është përdorur nga Rugova dhe Sejdiu-Rugova, shih: B. RUGOVA, L. SEJDIU- RUGOVA, *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Trembelat, Prishtinë, 2015, 122; po ashtu shih: K. BINAJ, *Modelet strukturore të fjalive në gjuhën shqipe*, ZERO PRINT, Prishtinë 2021.

11 M. DOMI (ed.), *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2002.

kërkesa semantike dhe sintaksore. Kështu, përzgjedhja e mënyrës së foljes në klauzën e varur komplementare¹², përcaktohet nga kërkesat semantike dhe sintaksore të foljes kryesore në fjalinë e përbërë. Folje të caktuara si *dua, dëshiroj*¹³, në përputhje me semantikën e tyre modale, rregullisht përzgjedhin mënyrën lidhore në klauza komplementare, p.sh. *Dua të punoj*. Ndërsa disa folje të tjera siç janë ato të të perceptuarit *shoh, dëgjoj, kuptoj*, që janë folje që paraqesin perceptim të drejtpërdrejtë, në përputhje me semantikën e tyre, rregullisht e kërkojnë dëftoren, p.sh. *E shoh që po vjen*. Ndryshe nga këto, në fjalitë me klauza rrethimore përzgjedhja e lidhore në klauzën e varur varet nga faktorë të tjerë, siç janë p.sh. tipi i lidhëzës apo vetitë semantike të saj: në fjalitë me klauza kushtore lidhëza *sikur*, e cila përdoret vetëm me lidhoren¹⁴, ka domethënie të theksuar hamendësuese. Kjo domethënie e saj bën që ajo të përdoret vetëm me lidhoren duke paraqitur një hipotezë kundërfaktuale, p.sh. *Do ta takoja, sikur të vinte atë ditë*. Ndryshe nga *sikur*, lidhëzat *nëse* apo *në qoftë se* lidhen vetëm me dëftoren, duke shprehur kështu një kusht real p.sh. *Nëse vjen nesër, do ta takoj*. Pra, ekzistojnë faktorë të ndryshëm që ndikojnë në përzgjedhjen e mënyrës lidhore në klauzat e varura. Megjithatë, një gjë që mund të vërejmë gjer këtu, është fakti se ka një përputhje semantike ndërmjet mjeteve që e përcaktojnë përdorimin e lidhore, siç janë foljet modale *dua, dëshiroj*... dhe vetë semantikës së lidhore: përmbajtja e modalitetit irrealis. Rrjedhimisht, në përputhje me domethënien e lidhore, në këto kontekste përdorimi i saj përkon me irrealisin. Megjithëkëtë, siç do ta paraqesim më poshtë gjatë punimit, në disa tipa fjalish me klauza komplementare, përzgjedhja e lidhore bëhet nga disa folje semantika e të cilave nuk është fare në përputhje me përmbajtjen ireale të lidhore. Këtu është fjala për përdorimin e lidhore në klauzat komplementare, përzgjedhur nga foljet aspektore si *nis, filloj, vazhdoj*..., si p.sh. *Nis të shkruaj*. Kështu, pasi që trajtuam anën semantike të mënyrës lidhore dhe i pamë disa nga kontekstet në të cilat përdoret si dhe mjetet që ndikojnë në përzgjedhjen e saj, në vazhdim do të analizojmë gjerësisht përndarjen e

12 Termi *komplement* përdoret për t'iu referuar plotësve të cilët i kërkon një folje për të ndërtuar një strukturë minimale të fjalisë, shih: HUDDLESTONE DHE PULLUM, *The Cambridge Grammar...*, 218. Rrjedhimisht, termi klauza komplementare përdoret për t'iu referuar klauzave që kanë funksionin e komplementit foljor ndaj foljes drejtuese. P.sh. në fjalinë *Dua të punoj*, klauza e varur *të punoj* ka funksionin e komplementit foljor (klauzës komplementare) në raport me foljen *dua*, sepse i nevojitet asaj në mënyrë që ta ndërtojë një strukturë minimale sintaksore dhe semantike. Në funksion të klauzave komplementare në gjuhën shqipe mund të dalin klauzat kryefjalore, kundrinore dhe ato plotëse kallëzuesore, shih: K. BINAJ, *Modelet strukturore...*, 2001.

13 F. TOPALLI, G. TURANO, *Hyrje në gramatikën gjenerative të shqipes*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 108.

14 *Ibid.*, 120.

saj në kontekstin e fjalive të përbëra në gjuhën shqipe. Krahas fjalive me klauza komplementare, do të paraqesim dhe do të analizojmë përndarjen e saj edhe në fjalitë me klauza rrethanore (jo në të gjitha përdorimet e mundshme, por vetëm në përdorimet më të zakonshme) dhe në ato përcaktore. Do t'i analizojmë faktorët që e përcaktojnë përzgjedhjen e saj në këto kontekste të përdorura. Do të shohim se çfarë paraqet përdorimi i lidhës në secilin kontekst të përdorimit duke u përpjekur të paraqesim karakteristikat themelore të lidhës së shqipes që e bën atë të jetë një mënyrë me përndarje mjaft të gjerë në kontekstin e fjalive me klauza të varura dhe njëkohësisht të ketë përndarje në kontekste mjaft heterogjene.

2. Metodologjia e punës

Ky punim është një trajtim teorik-analitik i përndarjes së lidhës në fjalitë e përbëra në gjuhën shqipe. Fillimisht është paraqitur një përshkrim i anës semantike të lidhës, pastaj janë analizuar faktorët semantikë dhe sintaksorë që ndikojnë në përzgjedhjen e saj në tipa të ndryshëm të fjalive të përbëra si dhe është analizuar tipi i kontekstit realis apo irrealis që mund të ndërtojë lidhë e shqipes. Për këtë analizë nuk është përdorur një korpus i veçantë. Shembujt që janë përdorur për të ilustruar përdorimin e lidhës në kontekste të ndryshme, janë përzgjedhur sipas rastit.

3. Lidhë e fjalitë e përbëra

Tipat e fjalive të përbëra në të cilat përdoret lidhë janë ndarë në tri grupe, varësisht nga tipi i klauzës së varur:

- a) në fjali me klauza të varura rrethanore: kushtore, kohore, qëllimore, kushtore-lejore, të kufizimit, etj.;
- b) në fjali me klauza të varura përcaktore;
- c) si dhe në fjalitë me klauza të varura komplementare (kundrinore, kryefjalore);

Përndarja e lidhës në fjali të përbëra është klasifikuar në tri grupe kontekstesh, meqë janë identifikuar tre faktorë të ndryshëm që lidhen me përdorimin e saj. Gjersa në rastin e fjalive me klauza komplementare (komplement foljor) përzgjedhja e lidhës varet nga folja drejtuese, nga nevojat semantike e strukturore të saj, në fjalitë me klauza rrethanore nuk ndodh një gjë e tillë. Përzgjedhja e lidhës në këto fjali përcaktohet nga lidhja e kohës së foljes drejtuese me lidhëzën, ose vetëm nga lidhëza, nga vetitë semantike të saj, apo në rastin e fjalive qëllimore, është vetë tipi i fjalisë që e përcakton përdorimin e lidhës. Në klauza të varura përcaktore përzgjedhja e lidhës lidhet me përdorimin joreferencial të emrit të pashquar (në pjesën drejtuese) që përcaktohet nga klauza përcaktore.

3.1. Lidhja në klauza rrethore dhe lidhëzat

3.1.1. Lidhja në klauza kushtore

Ashtu siç paraqitet në Gramatikën e Akademisë¹⁵, lidhja është mënyrë e foljes që ka përndarje mjaft të gjerë në fjalitë e përbëra, në klauzat rrethore të tyre. Në rastin e këtyre fjalive, përkatësisht klauzave të varura të tyre, përzgjedhja e lidhjes nuk përcaktohet nga natyra e foljes së klauzës drejtuese. Në këto fjali, klauza e varur e plotëson foljen e klauzës drejtuese, mirëpo nuk lidhet me valencën e saj, nuk është element i domosdoshëm strukturor dhe semantik i saj. Rrjedhimisht, edhe përzgjedhja e lidhjes (apo dëftores), nuk varet nga nevojat semantike të foljes drejtuese. Faktorët që lidhen me përdorimin e lidhjes këtu janë më heterogjenë se sa në rastin e klauzave komplementare. Një faktor i rëndësishëm është tipi i lidhëzës apo semantika e saj. Kështu, p.sh. në fjalitë me klauza kushtore, lidhëza *sikur* mund të lidhet vetëm me lidhoren, nuk mund ta marrë dëftoren (siç ndodh me lidhëzat e tilla si *nëse*, *në qoftë se*, të cilat lidhen vetëm me dëftoren). Lidhëza *sikur* karakterizohet nga përmbajtja e hamendësimit dhe, duke u lidhur me kohën e pakryer ose më se të kryerën e lidhjes në klauzën e varur, paraqet një kusht joreal apo kundërfaktual. Në këtë lloj lidhjeje klauza kushtore, po ashtu, përmban qëndrim emocional të folësit, një pakënaqësi:

3. a) *Sikur të vije në kohë, do ta gjeje këtu.*

b) *Sikur të kishe ardhur në kohë, do ta kishe gjetur këtu.*

**Sikur vjen në kohë*

Në fjalitë e përbëra kushtore me lidhoren mund të përdoret edhe lidhëza *po*, megjithëse me këtë lidhëz mund të përdoret edhe e kryera e thjeshtë e dëftores¹⁶. Këto dy lloje klauzash kushtore, që në shqipen janë karakteristike më shumë për gjuhën e folur, janë sinonime në referencën kohore të së ardhmes dhe në modalitetin që e shprehin. Që të dyja shprehin kushte të hapura. Megjithatë, vështroar nga aspekti pragmatik, ilustrimi në b) me dëftoren, shpreh një siguri më të lartë (një bindje më e lartë) të folësit, krahasur me atë në a) me lidhoren:

4. a) *Po të shkosh tani, e gjen aty.*

b) *Po shkove tani, e gjen aty.*

Pra, ndonëse lidhëza *po* ka përndarje më të gjerë me lidhoren, është karakteristike më shumë për të, ajo mund të përdoret edhe me dëftoren. Por, ndonëse përdoret me të dyja mënyrat, ka dallime në nuancat kuptimore.

Lidhëza *po* përdoret edhe me lidhoren e pakryer dhe me më se të kryerën, ndërsa në klauzën drejtuese kërkon të ardhmen e së shkuarës, përkatësisht të ardhmen e përparme të së shkuarës. Që të dyja strukturat

15 M. Domi (ed.), *Gramatika e gjuhës shqipe II*. 2002.

16 *Ibid.*, 587.

kushtore paraqesin kushte të mbyllura, joreale, pra kushte që nuk janë në përputhje me realitetin aktual:

5. a) Po të shkoje atje, do ta gjeje.

b) Po të kishe shkuar atje, do ta kishe gjetur.

Lidhëzat janë mjeti kryesor në fjalitë me klauza rrethanore për shprehjen e marrëdhënieve sintaksore, dhe bashkë me foljet, edhe për ndërtimin e kuptimeve kohore dhe modale. Nisur nga ky funksion i lidhëzave, Totoni¹⁷ i ndan ato në lidhëza me kuptim të diferencuar dhe lidhëza me kuptim të padiferencuar. Kështu, duke qenë se lidhëza *po* mund të lidhet edhe me të kryerën e thjeshtë të dëftores dhe me të tashmen e lidhore, për të paraqitur një kusht të hapur a real, por edhe me të pakryerën e me më se të kryerën e lidhore, për të paraqitur një kusht të mbyllur a joreal, është lidhëz me kuptim të padiferencuar. Ndërsa lidhëza *sikur* është lidhëz me kuptim të diferencuar. Për shkak të karakterit të theksuar hamendësues që ka, lidhet vetëm me lidhoren, me kohë të ndryshme të saj, për të shprehur një kusht të mbyllur, por nuk mund të lidhet me dëftoren në asnjë rast. Lidhëza *sikur* mund të lidhet me lidhoren, kohën e kryer të saj, për të shprehur një hamendësim për të shkuarën, verifikimi i të cilit është ende i hapur:

6. ...po, sikur ta ketë parë dikush... le të kërkojmë më shumë...

3.1.2. Lidhorja në klauza kohore

Bazuar në klasifikimin e Totonit të paraqitur më lart, lidhëza kohore *kur* është lidhëz me kuptim të padiferencuar, prandaj ajo mund të lidhet edhe me lidhoren edhe me dëftoren. Lidhet me dëftoren, për të shprehur nuanca të ndryshme kohore, me referencë në të tashmen ose në të shkuarën (7a) dhe b)), brenda tyre për të shprehur nuanca kohore njëkohësie në të tashmen a në të shkuarën (7a)) dhe jonjëkohësie në të shkuarën, paskohësi¹⁸ a parakohësi¹⁹ (7b)), por për të shprehur referenca kohore të paskohësisë (8 a)) dhe të parakohësisë (8b)) në të ardhmen, lidhëza **kur** lidhet vetëm me lidhoren:

7. a) Kur unë punoj në kompjuter, ai lexon. / Kur unë punoja në kompjuter, ai lexonte.

b) Kur erdha në qytet, e takova Artën / Kur hyri në dhomë, atë e kishte zënë gjumi.

8. a) Kur t'i përfundojë detyrat, do ta shikojmë një film.

b) Kur të zgjohemi, çdo gjë do të ketë mbaruar.

17 M. TOTONI. *Sintaksa e gjuhës shqipe – Faza e përbërë*, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2012, 187-189.

18 Situata e klauzës drejtuese ndodh pas situatës së klauzës së varur.

19 Situata e klauzës drejtuese ndodh para situatës së klauzës së varur.

Lidhëza *pasi* është lidhëz kohore me kuptim të diferencuar, pasi që gjithmonë shpreh marrëdhënie paskohësie në të shkuarën, të tashmen ose në të ardhmen. Kuptimi i paskohësisë në të ardhmen mbështetet në bashkëlidhjen e saj me mënyrën lidhore (9a). Për të shprehur këtë referencë kohore, nuk mund të përdoret ndonjë strukturë tjetër (b):

9. a) *Pasi të pushojë shiu, do të dalim jashtë.*

b) **Pasi pushon/do të pushojë shiu, dalim jashtë.*

Siç ilustrohet në 9 a) koha e klauzës së varur i prin kohës së klauzës drejtuese, por e tërë referenca kohore lidhur me çastin e të folurit, është për të ardhmen. Prandaj në këtë kontekst lidhëza *pasi* lidhet me lidhoren, përshtatet me semantikën ireale të saj. Përkundrazi, nëse tërë ngjarja e referuar në lidhje me çastin e ligjërimit i përket së shkuarës, atëherë lidhëza *pasi*, lidhet me dëftoren, me kohën e kryer të thjeshtë apo me të pakryerën:

Pasi erdhi ai, u ulëm për të biseduar.

Pasi mbërrija në shtëpi, çdo herë e telefonja atë.

Lidhëza *para se*, po ashtu është lidhëz kohore me kuptim të diferencuar, pasi që gjithmonë shpreh marrëdhënie kohore parakohësie, në të shkuarën (10a) ose në të ardhmen (10b): situata e shprehur nga klauza e drejtuese i prin situatës së shprehur në klauzën varur:

10. a) *Para se të nisej, e lajmëroi.*

b) *Më lajmëro, para se të nisesh.*

Në ilustrimin në (10a) referenca kohore është për të shkuarën. Mirëpo situata e shprehur në klauzën e varur me foljen në lidhore, në raport me drejtuesen është situatë e pritshme, prandaj lidhëza *para se* e kërkon lidhoren dhe nuk mund të marrë dëftoren.

**** Para se nisej, e lajmëroi.***

3.1.3. Lidhorja në tipa të tjerë të klauzave rrethanore

Lidhoren e gjejmë të përdorur edhe në lloje të tjera të klauzave rrethanore, si p.sh. në ato të krahasimit me lidhëzat *si* e *sikur*²⁰. Lidhëza *sikur* në këtë kontekst nuk mund të lidhet me të tashmen e lidhore, por vetëm me të pakryerën e saj duke shprehur një krahasim të hamendësuar:

11. a) *(Po) Flet si/sikur të kishe diçka për të fshehur.*

Sikur në një fjali të ngjashme mund të përdoret edhe me dëftoren:

b) *Po flet sikur ke dicka për të fshehur.*

Mirëpo, gjersa në përdorimi me dëftoren në b) folësi shpreh një siguri apo

20 M. Domi (ed.), *Gramatika e gjuhës shqipe II*, 614.

bindje më të lartë në lidhje me atë që e thotë: *bindjen që bashkëbiseduesi ka diçka që është duke e fshehur*; në rastin me lidhoren në a) folësi distancohet nga ajo që e thotë duke e theksuar më tepër karakterin hamendësues të supozimit të tij.

Në fjali me klauza kushtore – lejore, duke pasur parasysh shprehjen e një kushti hamendësues, është i natyrshëm përdorimi i lidhores. Në 12) lidhorma në korelacion me lokucionin *edhe po* shpreh një kusht të hamendësuar, i cili nuk do ta pengonte (mos)realizimin e situatës në klauzën drejtuese:

12. *Edhe po të ishte* ashtu, s'do ta lejoja.

Si përfundim, përdorimi i lidhores në klauzat rrethimore lidhet ngushtë me tipin e lidhëzës, në rastin e lidhëzave me kuptim të diferencuar. Në rastin e lidhëzave me kuptim të padiferencuar, përdorimi i lidhores përcaktohet nga lidhja që krijohet nga lidhëza me kohën e foljes drejtuese, pra me referencën e përgjithshme kohore të së ardhmes. Vështuar në anën pragmatike, përdorimi i lidhores lidhet me qëllimin e folësit: kur përdor dëftoren folësi shpreh siguri apo bindje më të lartë në lidhje me atë që thotë, ndërsa kur e përdor lidhoren shpreh një distancim në lidhje me atë që thotë.

3.1.4. Lidhorma në fjalitë qëllimore

Në përputhje me domethënien e saj, dhe në përputhje me kuptimin e fjalive me klauza qëllimore, lidhorma në shqipen është e vetmja mënyrë e foljes që mund të përdoret në këto klauza. Këtë gjë pohon edhe Gramatika e Akademisë²¹:

13. a) *Vij (që) të punoj.*

b) *Do të vij (që) të punoj.*

Siç e shpjegon Totoni²² fjalja kryesore e përmban shpjegimin e synimit të pritshëm *vij/do të vij*, fjalja e ndënrenditur e kumton vetë qëllimin *që të punoj*. Në këtë tip fjalie, nuk ka një mjet specifik gramatikor që e kërkon lidhoren, që krijon korelacion me të. Mirëpo, duke qenë se klauza e varur qëllimore shpreh një situatë joreale, situatë të pritshme, atëherë ajo është në përputhje me konceptin e lidhores. Fjalja e përbërë me klauzë qëllimore mund të përmbajë edhe referencë kohore në të shkuarën, mirëpo qëllimi i shprehur nëpërmjet klauzës qëllimore, çdo herë paraqet një situatë të pritshme në raport me situatën e klauzës drejtuese:

14. a) *Erdhi (me qëllim që/që) të punonte.*

Nga vëzhgimet gjer më tani për fjalitë e përbëra me klauza rrethimore,

21 M. Domi (ed.), *Gramatika e gjuhës shqipe II*, 556.

22 M. Totoni. *Sintaksa e gjuhës shqipe*, 189.

mund të shohim se përdorimi i lidhore shënon situata të paaktualizuara, të pritshme, të hamendësuara dhe situata kundërfaktuale. Vëzhguar në aspektin strukturor, mund të përfundojmë se përdorimi i saj në këto kontekste varet nga disa faktorë, siç janë: vetitë semantike të lidhëzës: varësisht nga lidhëza mund të shprehen referenca kohore dhe modalitete të caktuara në klauzën e varur dhe në tërë fjalinë; nga lidhja i lidhëzës me foljen drejtuese, si dhe nga vetë tipi i fjalisë: në rastin e fjalive qëllimore, duke qenë se flitet për një situatë të ardhshme, jofaktuale, dhe duke qenë se lidhja është mënyrë e foljes që shpreh një përmbajtje të tillë, përdorimi i saj në këto kontekste është i pritshëm.

3.2. Lidhja në fjalitë përcaktore – Pashquarësia: përdorimi joreferencial i emrit dhe lidhja

Në gjuhën shqipe lidhja mund të përdoret në një klauzë të varur të një fjalie të përbërë, duke paraqitur një gërshetim funksional: mund të interpretohet edhe si përcaktore (15a), edhe si qëllimore (15b) (Gjithsesi, fjalitë dallojnë ndërmjet vete sepse në versionin me interpretim përcaktor, kryefjala e klauzës së varur është në vetën e tretë, shprehet nga përmeri lidhor *që*, ndërsa në interpretimin qëllimor, kryefja e klauzës drejtuese dhe asaj të varur është e njëjta). Për shkak të fokusit të analizës sonë, këtu po ndalemi vetëm në interpretimin e saj në funksion përcaktor, ndonëse ky funksion duket më periferik në shqipen:

15. a) Po kërkoj një libër që ta shtjellojë këtë problem në detaje.

= i cili mund ta shtjellojë këtë problem në detaje

b) Po kërkoj një libër që ta shtjelloj këtë problem në detaje.

= në mënyrë që ta shtjelloj këtë problem në detaje

Përdorimi i lidhore në klauzën e varur përcaktore lidhet me përdorimin joreferencial të emrit të pashquar në funksion të kundrinës në klauzën drejtuese (15a). Kështu, emri i pashquar në funksion të kundrinës së drejtë kërkon lidhoren në klauzën përcaktore, duke paraqitur një situatë hipotetike, pra jofaktuale. Emri *një libër* ka përdorim joreferencial (15a), sepse referenca e tij paraqitet në mënyrë hipotetike: *nuk dihet nëse ai ekziston apo jo*²³.

Në rast se kundrina e drejtë *një libër*, kalon në trajtën e shquar dhe lidhet me lidhoren në klauzën e varur (16), atëherë klauza e varur shpreh vetëm funksion qëllimor, por jo më përcaktor (Në funksion qëllimor, kryefjala e foljes drejtuese dhe e asaj të varur është e njëjtë, ndryshe nga interpretimi në funksion përcaktor):

16. Po e kërkoj librin që ta shtjelloj këtë problem në detaje.

23 “Një libër” nuk tregon një entitet në Universin e Diskursit, shih Givon, 2001, 438.

Në rast se lidhorja në klauzën e varur përcaktore zëvendësohet nga dëftorja, dhe emri në funksion të kudrinës së drejtë në pjesën drejtuese del në trajtën e shquar, atëherë do të ndërrojë edhe modaliteti: nga shprehja e një shtate jofaktuale do të kalojë në një shtatë faktuale apo në modalitet faktual (17a). Në këtë rast emri *librin* ka përdorim referencial, sepse nënkupton faktin se një libër i tillë tashmë ekziston²⁴:

17. a) *Po e kërkoj librin që e shpjegon këtë problem në detaje (duhet të jetë këtu diku).* – dëftore

Ilustimi i paraqitur për shqipen është përshtatur nga Cristofaro²⁵. Duke shpjeguar këtë dukuri për italishten, Cristofaro pohon se përzgjedhja e mënyrës në klauzat përcaktore, përcaktohet nga vetitë semantike të pjesëmarrësit të përbashkët të klauzës drejtuese dhe asaj të varur. Sipas saj, në qoftë se pjesëmarrësi përkatës prezentohe ose konceptohet sikur ai ekziston, ai funksionon si kokë referente dhe situata në klauzën përcaktore është faktuale (17a), ndërsa, në qoftë se pjesëmarrësi përkatës nuk perceptohet si ekzistues (15a), atëherë koka e klauzës përcaktore është joreferente dhe situata në klauzën përcaktore është jofaktuale.

3.3. Lidhorja në klauza komplementare

Ashtu siç theksohet nga Turano²⁶ në fjalitë e varura me klauza komplementare, klauza komplementare me lidhoren ka funksionin e komplementit²⁷ të foljes drejtuese. Rrjedhimisht, në aspektin strukturor e semantik ajo varet nga valenca e foljes drejtuese. Veç kësaj, vetitë semantike e modale të foljes drejtuese (në masë të gjerë) përcaktojnë edhe shprehjen e komplementit foljor: nëse ai do të jetë i shprehur me lidhoren, apo me dëftoren. Foljet që marrin një klauzë – pra një tjetër

24 “Librin” tregon një entitet në Universin e Diskursit.

25 S. CRISTOFARO, *Subordination (Oxford Studies in Typology and Linguistic Theory)*, Oxford University Press – Oxford 2003, 168.

26 F. KOLECI, G. TURANO, *Hyrje në gramatikën...*, 108.

27 Termi *komplement* përdoret për t’iu referuar plotësve të cilët shoqërojnë foljen për të ndërtuar strukturën minimale të fjalisë, shih: HUDDLESTONE, PULLUM, *The Cambridge Grammar...*, 218. Në gjuhën shqipe, zakonisht kryefjala dhe kundrina janë komplementë të foljes, varësisht nga valenca e foljes, p.sh. në fjalinë *Ajo erdhi* – foljes *erdhi* i nevojitet kryefjala *ajo*, për ta ndërtuar një strukturë minimale të fjalisë; ndërsa në fjalinë *Ajo bleu një libër* – për ta ndërtuar një fjali me strukturë minimale, foljes *bleu* i nevojitet kryefjala *ajo* dhe kundrina *një libër* (nëse e largojmë kundrinë *një libër*, dhe mbetet vetëm pjesa *Ajo bleu*, fjali do të mbetet e mangët edhe në anë sintaksore edhe në atë semantike). Megjithatë, ndonjëherë edhe një rrethanor mund të jetë elememt i domosdoshëm, në mënyrë që folja të krijojë një strukturë minimale të fjalisë, p.sh. *Ajo banon në Prishtinë* - foljes *banon* i nevojitet rrethanori *në Prishtinë* për të ndërtuar një fjali semantike. Për më shumë shih: K. BINAJ, *Modelet strukturore...*, 2021, 79.

predikat si komplement të tyre, Givoni²⁸ i klasifikon në tri klasë (të cilat kanë nënklasifikime të mëtejshme, por që nuk do t'i paraqesim këtu më hollësisht). Në grupin e parë hyjnë foljet e modalitetit, të cilat shprehin qëndrime modale si dëshirë, vullnet, gatishmëri, frikë etj., e që mund të ilustron nëpërmjet foljeve të tilla si *dua, dëshiroj, planifikoj, shpresoj, refuzoj, frikësohem*; në këtë grup hyjnë edhe foljet aspektore si *filloj, vazhdoj, arrij, përfundoj* etj. Në grupin e dytë, hyjnë foljet e manipulimit, të cilat paraqesin të manipuluarit e një agjenti njerëzor mbi një të manipuluar. Të tilla janë foljet *urdhëroj, kërkoj, them* (kjo e fundit, në kuptim urdhëror) por edhe foljet *detyroj, lë, bëj, ndihmoj* etj. Dhe në grupin e tretë hyjnë foljet e perceptimit, njohjes dhe të të shprehurit, karakteristikë e të cilave është fakti se kryefjala e tyre percepton apo njeh një gjendje a ngjarje, apo shpreh një propozicion në lidhje me një gjendje a ngjarje. Të tilla janë foljet *shoh, dëgjoj, mendoj, di, njoh, them, pohoj* etj. Secila nga këto klasë foljesh ka karakteristikat e tyre semantike, sintaksore dhe logjike, për të cilat nuk do të zgjerohemi hollësisht në kuadër të këtij trajtimi²⁹, por do t'i sqarojmë dhe interpretojmë vetëm kur ato janë relevante për këtë analizë.

Në gjuhën shqipe lidhorja del si komplement klauzal i foljeve që i përkasin klasës së parë dhe të dytës. Pra, ajo përzgjidhet nga foljet që shprehin dëshirë: *dua, dëshiroj, uroj*; nga foljet e manipulimit si *urdhëroj, kërkoj* por edhe *bëj, ndihmoj, detyroj*; dhe foljet aspektore: *filloj, nis, vazhdoj*³⁰.

Kështu, rregullisht lidhorja përzgjidhet nga folje të tilla si *dua, dëshiroj etj.*, që janë folje të modalitetit, ose nga foljet e manipulimit siç janë *urdhëroj, kërkoj, detyroj* etj. Këto folje kërkojnë klauza komplementare me lidhoren (18a) dhe (18c), por nuk mund të marrin një me dëftoren (18b) dhe (18d):

18. a) Ata donin *ta merrnin* me vete qenin.

b) *Ata donin (që) marr me vete qenin.

c) Ata kërkuan që secili të vijë në kohën e caktuar.

d) *Ata kërkuan që secili vjen/vinte në kohën e caktuar.

Përzgjedhja e lidhores nga këto folje është e pritshme, duke pasur parasysh faktin se ato janë folje të modalitetit, përkatësisht të manipulimit. *Dua* është folje e modalitetit, që shpreh një qëndrim modal si dëshirë, vullnet, gatishmëri etj. Në aspektin logjik, karakteristikë e shumicës së foljeve të modalitetit (*dua, dëshiroj*) është se i takojnë një modeli logjik joimplikativ (jonënkuptues). Kjo nënkupton faktin se vërtetësia që shprehin ato në klauzën drejtuese, nuk nënkupton vërtetësinë e klauzës komplementare

28 T. GIVON, *Syntax I*, 149.

29 *Ibid.*, 149 - 155.

30 Shih: F. KOLECI, G. TURANO, *Hyrje në gramatikën...*, 109.

apo nuk shtrihet mbi klauzën e saj komplementare³¹: *pse ata donin ta merrnin me vete qenin, nuk d.t.th. patjetër që e kanë marrë*:

19. a) *Ata donin ta merrnin me vete qenin.*
(≠ e morën me vete qenin)

Kërkoj është folje e manipulimit, që shpreh një direktivë. Më saktësisht, *kërkoj* është folje e përpjekjes për manipulim: shpreh përpjekjen e agjentit për manipulim ndaj një pjesëmarrësi tjetër– të të manipuluarit³². Në aspektin e vetive të tyre logjike, karakteristikë e këtij tipi foljesh është fakti se ato janë joimplikative. Vërtetësia që shpreh folja drejtuese *kërkoj*, nuk shtrihet mbi klauzën e saj komplementare: *pse ata kerkuan që secili të vinte në kohën e caktuar, nuk d.t.th. që ata me të vërtetë kanë ardhur*:

20. *Ata kerkuan që secili të vinte në kohën e caktuar.*
(≠ sicili erdhi në kohë)

Këto veti semantike dhe logjike të foljeve të tilla si *dua*, *kërkoj* bëjnë që ato të kërkojnë lidhoren në klauzën e tyre komplementare dhe nuk mund ta marrin dëftoren. Dëftorja është mënyrë që shpreh një pohim faktual, prandaj ajo nuk mund të përzgjidhet nga një folje e tillë si *dua* apo *kërkoj*, por përzgjidhet lidhorja, e cila shpreh mungesën e një pohimi të tillë.

Megjithatë, ka folje të tilla si *them*, *telefonoj* të cilat mund të zgjedhin që të dy mënyrat³³. P.sh. në gjuhën shqipe folja *them* mund të ndërtojë fjali të përbërë duke përzgjedhur një klauzë komplementare qoftë me dëftoren, qoftë me lidhoren, por që klauza komplementare shënon dy mesazhe të ndryshme:

21. a) *Arta tha që dikush erdhi sot.*
b) *Arta tha që dikush të vijë sot.*

Gjersa në **a)** klauza komplementare shpreh një pohim në lidhje me ardhjen e dikujt, ajo në **b)** shpreh një direktivë në lidhje me ardhjen e dikujt. Me fjalë të tjera, folja *them*, në shembullin në **a)** përdoret si folje e të thënit (i përket grupit të tretë të foljeve sipas klasifikimit të Givonit, paraqitur më sipër - folje të përciptimit, të njohjes dhe të të thënit): meqë shpreh një pohim të dikujt (Artës) në lidhje me një situatë, andaj e kërkon dëftoren, ndërsa në shembullin **b)**, përdoret si folje e manipulimit (që shpreh një urdhër): meqë shpreh një urdhër a kërkesë të dikujt (Artës), në lidhje me një situatë, andaj ajo e kërkon lidhoren. Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me folje që përdoren me domethënie të ndryshme. Siç thekson Farkas³⁴

31 T. GIVON, *Syntax I*, 151.

32 *Ibid.*, 153.

33 D. FARKAS. *On the Semantics of Subjunctive Complements*, 70;

34 *Ibid.*, 71.

ndërrimi i domethënies së foljes në këto raste, shoqërohet më ndërrimin e mënyrës, dukuri që është karakteristike edhe për gjuhë të tjera.

Përndarja e lidhore në kontekstet e ilustruara gjer tani, ka të bëjë me situata të ardhshme, jofaktuale – situata që i përkasin fushës konceptuale të irrealitetit. Përzgjedhja e saj në këta tipa fjalish është në përputhje me vetitë semantike e logjike të foljeve drejtuese të këtyre fjalive: folje të modalitetit e folje të manipulimit (përkatësisht, të përpjekjes për manipulim). Karakteristikë e rëndësishme e këtyre foljeve (*dua, dëshiroj, kërkoj...*), është fakti se ato i takojnë modelit logjik joimplikativ (jonënkuptues): vërtetësia që shprehin ato në pjesën drejtuese, nuk nënkupton vërtetësinë e klauzës komplementare apo nuk shtrihet mbi klauzën komplementare. Rrjedhimisht, përzgjedhja e lidhore në këto kontekste është e pritshme.

Në grupin e foljeve të manipulimit hyjnë edhe foljet të tilla si *bëj, ndihmoj, detyroj, parandaloj* etj., të cilat, po ashtu, në gjuhën shqipe përzgjedhin një komplement me lidhoren³⁵. Ky grup i foljeve njihen edhe si folje kauzative. Foljet kauzative paraqesin një veprim, në të cilin një agjent (zakonisht kryefjala drejtuese) është stimul që shkakëton apo mundëson që dikush tjetër të kryejë një veprim. Pra, ato paraqesin një marrëdhënie shkakësore, në të cilën kryefjala bën që veprimi të kryhet nga dikush ose diçka tjetër. Rrjedhimisht, grupi i foljeve kauzative dallon nga foljet e tjera të manipulimit siç janë foljet *kërkoj, urdhëroj*: gjersa të parat, në aspektin logjik janë joimplikative, foljet kauzative janë folje implikative:

22. Ajo e bëri të qajë.

(= Ai qau)

Vërtetësia që shprehet nëpërmjet foljes drejtuese *bëj*, shtrihet mbi komplementin e saj klauzal *të qajë*: d.m.th. *ai qau*. Kjo veti e lidhore që të lidhet me foljet kauzative, të cilat nuk përputhen me konceptin e lidhore, shfaqet edhe në gjuhë të tjera³⁶.

Në gjuhën shqipe janë edhe disa tipa fjalish me klauza komplementare në të cilat lidhorja përzgjidhet nga folje që kanë semantikë krejtësisht tjetër nga ajo e lidhore. Në këtë tip fjalish, lidhorja drejtohet nga folje të tilla si *filloj*³⁷ por edhe foljet e tjera aspektore si *nis, vazhdoj, arrij* etj. Foljet aspektore, bashkë me foljet kauzative, dallojnë nga foljet e tjera të përmendura më sipër për faktin se paraqesin situata reale, faktuale. Në gjuhën shqipe këto folje, në klauza komplementare rregullisht e përzgjedhin lidhoren, dhe nuk lejojnë përzgjedhjen e dëftores. Në aspektin

35 F. KOLECI, G. TURANO, *Hyrje në gramatikën...*, 114.

36 L. SIEGEL. *Factivity, Causatives, and the Distribution of Subjunctive Mood*. 2004: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.del.auth.gr/GLOË2004/abstracts/Siegel.pdf>.

37 B. RUGOVA, *E ardhmja në bast...*, 37.

logjik, foljet aspektore i përkasin modelit logjik implikativ (nënkuptues). Vërtetësia që shprehin ato në pjesën drejtuese shtrihet mbi komplementin e tyre klauzal³⁸:

23. a) Ajo filloi të punojë. = Ajo punon.

b) Ajo vazhdon të studiojë në mjekësinë molekulare. = Ajo studion mjekësi molekulare.

c) Fëmijët ia arritën ta fitojnë garën. = Fëmijët e fituan garën.

d) Ajo ia doli të notojë deri në breg. = Notoi deri në breg.

Nëse i referohemi përkufizmit për mënyrën lidhore- mënyrë që i përket fushës konceptuale të irrealitetit, atëherë ky përdorim i këtillë i lidhore është i papritur. Përdorimi i lidhore në këto kontekste është karakteristik edhe për gjuhë të tjera ballkanike, si në rumanishten, greqishten, bullgarishten e serbishten³⁹. Socanac-u analizon përndarjen e lidhore në gjuhët ballkanike duke theksuar se lidhorja ballkanike ka një përndarje më të gjerë se shumica e homologeve të tyre ndërgjuhësore (gjuhëve romane, gjermanike e të tjera). Duke iu referuar Joseph-it⁴⁰, ai argumenton se arsyeja e përndarjes jotipike të lidhore në gjuhët e Ballkanit lidhet me humbjen e paskajores që ka ndodhur në këto gjuhë, një zhvillim specifik diakronik. Duke munguar paskajorja në këto gjuhë, përdorimin e saj i ka zënë lidhorja. Andaj, në gjuhët ballkanike lidhorja ka përdorim më të gjerë, duke u përdorur kështu edhe në kontekste në të cilat në gjuhë të tjera, siç janë gjuhët romane, përdoret paskajorja. Brenda shqipes, në varietetin gegë, duke qenë se në gjuhën e folur në domenin joformal ekziston edhe paskajorja, i gjejmë po ato ndërtime të foljeve aspektore implikative me paskajoren: *nisa me punu(e), fillova me vrapu(e), ia dola me fitu(e)* etj.

4. Përfundim

Përndarja e lidhore në fjalitë e përbëra në gjuhën shqipe kryesisht lidhet me kontekstet e irrealitetit, për të shprehur një situatë të ardhshme dhe jofaktuale, hipotetike, kundërfaktuale, megjithëse në disa kontekste ajo përdoret për të paraqitur situata që nuk janë të tilla. Lidhoren e shqipes e gjejmë edhe në kontekste të cilat i përkasin fushës konceptuale të realitetit, siç është rasti i fjalive komplementare me foljet kauzative *E bëri të qajë*, dhe me foljet aspektore *Nis të shkuaj*.

Në fjalitë me klauza rrethimore, në disa lloje të tyre, përzgjedhja e lidhore ka të bëjë me tipin e lidhëzës. Lidhëzat me semantikë të diferencuar janë të specializuara për të shprehur kuptime të caktuara, andaj ato lidhen

38 T. GIVON, *Syntax I*, 151.

39 T. SOCANAC, *Balkan Subjunctive Distribution: World Semantics and Default Selection*, Generative Grammar in Geneva, Vol. 17, Gjenevë 2017, 121.

40 Ivi.

me mjete përkatëse që përputhen me domethënien e tyre: *sikur* në fjalitë kushtore shpreh hamendësim të theksuar, andaj lidhet me lidhoren. Por, lidhorma në fjalitë me klauza rrethanore, përcaktohet edhe nga i tërë korelacioni ndërstrukturor: folja drejtuese + lidhëza + folja në lidhore, duke paraqitur referenca kohore të së ardhmes e modalitete përkatëse, si p.sh. në rastin e fjalive me klauza kohore.

Në fjalitë përcaktore përzgjedhja e lidhores në shqipen lidhet me pashquarësinë e emrit të klauzës drejtuese, duke paraqitur kështu një përdorimin joreferencial si entitetet në diskurs (për t'iu referuar një pjesëmarrësi hipotetik) ndryshe nga përzgjedhja e dëftores që lidhet me shquarësinë e emrit duke ilustruar një entitet referencial në diskurs (referohet një pjesëmarrësi ekzistues).

Në rastin e fjalive me pjesë të varura komplementare në njëfarë mase mund të themi që lidhorma varet nga folja drejtuese, nga karakteristikat semantike-logjike të saj e sintaksore (si në rastin e foljeve të modalitetit e foljeve të manipulimit), mirëpo jo çdo here. Përzgjedhja sistematike e saj nga foljet aspektore si *filloj, nis, vazhdoj* nuk mund të themi që motivohet nga ana semantike e logjike e tyre, meqë këto folje shprehin situata faktuale, të aktualizuara dhe janë folje implikative, që konceptualisht nuk janë në përputhje me kuptimin e lidhores.

Lidhorma në gjuhën shqipe ka një përndarje mjaft të gjerë dhe në kontekste mjaft heterogjene. Përtej faktit se shpreh një situatë jofaktuale, të paaktualizuar, semantikisht lidhorma ka një përmbajtje semantike mjaft të papërcaktuar.

BIBLIOGRAFIA

- B. ISMAJLI, *Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe haborja*, Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2012.
- B. RUGOVA *E ardhmja në bast – Futuri i shqipes*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (38), Prishtinë, 2020.
- B. RUGOVA, L. SEJDIU- RUGOVA, *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Trembelat, Prishtinë, 2015.
- D. FARKAS. *On the Semantics of Subjunctive Complements*. In P. HIRSCHBUHLER and K. KOENER (eds.), *Romance Languages and Modern Linguistic Theory* (Vol. 91), John Benjamins Publishing Company – Amsterdam/Philadelphia, 1992.
- F. KOLECI, G. TURANO, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2011.
- F. R. PALMER, *Mood and Modality*, Cambridge textbooks in Linguistics,

- Cambridge, 2001.
- J. BYBEE, R. PERKINS, W. PAGLIUCA, *The Evolution of Grammar: Tense, Aspect and Modality in the Languages of the world*, The University of Chicago Press - Chicago and London, 1994.
- J. QUER, *Twists of mood: The distribution and interpretation of indicative and subjunctive*, "Lingua", 2009.
- K. BINAJ, *Modelet strukturore të fjalive në gjuhën shqipe*, Zero Print, Prishtinë 2021.
- K. TOPALLI, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2012.
- L. SIEGEL, *Factivity, Causatives, and the Distribution of Subjunctive Mood*, GLOW 2004 Workshop on Tense, Aspect and Modality 2004: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://www.del.auth.gr/GLOE2004/abstracts/Siegel.pdf.
- M. DOMI (ed.), *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- M. NOONAN, *Complementation*. In T. Shopen (ed.) *Language Typology and Syntactic Description* (Vol. II), Cambridge University Press – Cambridge, 2007.
- M. TOTONI. *Sintaksa e gjuhës shqipe – Fraza e përbër*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2012.
- S. CRISTOFARO, *Subordination*, Oxford Studies in Typology and Linguistic Theory, Oxford University Press, Oxford, 2003.
- SH. DEMIRAJ (ed.), *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- SH. DEMIRAJ, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1988.
- T. GIVON, *Syntax* (Vol. I). John Benjamins Publishing Company, Amsterdam – Philadelphia, 2001.
- T. GIVON, *Syntax. A functional-typological introduction*. (Vol. I), Benjamins Publishing Company, Amsterdam – Philadelphia, 1984.
- T. SOCANAC, *Balkan Subjunctive Distribution: World Semantics and Default Selection*, "Generative Grammar in Geneva" (Vol. 10), 2017.

